

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime prioritare

Nr.	Rekomandimi OSBE/ODHIR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
2	Organet e zbatimit të ligjit duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të identifikuar dhe hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, duke përfshirë blerjen e votës, presionin ndaj zgjedhësve dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, në mënyrë tërësore, në kohën e duhur dhe me transparencë. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht për mekanizmat e zbatueshme për denoncimin e shkeljeve, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj pasojave të denoncimit.	Progres i pamjaftueshëm	Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon angazhimin për: <i>Ndryshime në kuadrin ligjor:</i> Kuvendi i Shqipërisë nuk bëri asnjë ndryshim në Kodin Zgjedhor ose në Kodin Penal. Në legjisllacionin që trajton çështje të detyrave dhe funksionimit të institucioneve ligjzbatuese për parandalimin, identifikimin dhe dënimin e veprave penale që lidhen me zgjedhjet nuk është bërë asnjë ndryshim. Nuk janë bërë ndryshimet ligjore për të rritur transparencën e burimeve të financimit të partive politike. Nuk janë bërë ndryshime ose plotësime në legjisllacion për të rritur efektivitetin në zbatimin e mekanizmave që mund të përdoren për parandalimin e këtyre fenomeneve dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve. <i>Informim , edukim dhe sensibilizim</i> KQZ-Komisioneri shtetëror dhe organizata të Shoqërisë civile janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve për informimin, edukimin zgjedhor dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për nevojën e veprimit aktiv ndaj fenomeneve të shkeljes së legjisllacionit për zgjedhje.